



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

PËR: Anëtarësinë e Odës së Mjekëve të Kosovës;
Shërbimin Profesional të OMK-së;
Anëtarët e Kuvendit të OMK-së;
Anëtarëve të Komisioneve të Përhershme dhe organeve të tjera të OMK-së;

NGA: Dr. Pleurat Sejdiu, Mr. Sci., Kryetar i Odës së Mjekëve të Kosovës (OMK)

LËNDA: Qarkore informative lidhur veprimtarinë e OMK-së gjatë zbatimit të masave mbrojtëse qeveritare

Datë: 15 mars 2020

Të nderuar anëtarë dhe nëpunës të Shërbimit Profesional të OMK-së,

Siç jeni të njoftuar paraprakisht, Qeveria e Kosovës me datë 13.03.2020 ka nxjerrë Vendimin nr. 01/09, me të cilin janë përcaktuar masat mbrojtëse për parandalimin dhe trajtimin e virusit pandemik COVID 19. Me qëllim të zbatimit të Vendimit nr. 01/09 dhe për shkak të natyrës së veçantë të veprimtarisë së OMK-së, me këtë Qarkore Informative Ju njoftojmë për funksionimin e OMK-së për ditët në vijim, respektivisht deri në zbatimin e masave të tilla të përkohshme.

Që nga data 16 mars 2020, OMK-ja do të funksionojë si në vijim:

- Pezullohet puna me palë pranë Selisë së OMK-së, kështu që Zyrat e Selisë së OMK-së do të jenë të mbyllura. Të gjitha shërbimet e mundshme për anëtarët të OMK-së rekomandohet që të bëhen përmes ueb faqes zyrtare të OMK-së dhe postës zyrtare elektronike të OMK-së. Udhëzohen anëtarët e OMK-së që gjatë orarit të rregullt të punës për çdo informatë shtesë të kontaktojnë me zyrtarët kujdestar në numrin të telefonit zyrtar të OMK-së si në vijim: + 383 (0)49 872 300 dhe + 383 (0) 49 872 070;

- Pezullohen të gjitha mbledhjet e organeve të OMK-së deri në përfundimin e zbatimit të masave mbrojtëse; dhe
- Të gjitha procedurat që janë duke u zhvilluar pranë OMK-së pezullohen dhe rrjedhimisht afatet e tyre nuk do të rrjedhin deri sa të pushojë zbatimi i masave mbrojtëse;

Për shkak të gjendjes së krijuar, OMK-ja e përkushtuar që të zbatojë autoritetin e saj ligjor të përfaqësimit të të drejtave profesionale të mjekëve, do të jetë në dispozicion për anëtarësinë e saj në këto momente të vështira dhe sfiduese për profesionin e tyre fisnik.

Me respekt,
Dr. Pleurat Sejdiu, Mr. Sci.
Kryetar, OMK